



## **BASHKIA ROSKOVEC**

**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT**

**OBJEKTI: “Sistemimi I shkarjes së varrezave Kurjan”**

**RELACION TEKNIK**

Miratohet :  
Kryetari i Bashkise  
**Majlinda Bufi**



## “Sistemimi I shkarjes së varrezave Kurjan”

---

Vendi : Fshati Kurjan , Bashkia Roskovec

Pershkrim i pergjithshem, Bashkia Roskovec

Pas miratimit te ndarjes se re administrative-territoriale ne vitin 2015 , Roskoveci mbajti statusin e “Bashkise” si nje nga 61 bashkite e vendit tone. Pozitiv eshte fakti se kjo bashki rifitoi territoret e saj duke perfshire edhe fshatrat e ish-komunave Strum , Kuman e Kurjan. Qendra e Bashkise eshte ne Roskovec dhe ka ne perberje edhe 3 Njesi Administrative : Kuman, Kurjan dhe Strum.

Aktualisht perfshihen 14 fshatra, me nje popullsi prej rreth 32 163 banore, sipas rregjistrit te Gjendjes Civile.


Kurjani eshte nje fshat i pozicionuar ne lindje te qytetit te Roskovecit, i cili njihet per terrenin kodrinor . Popullsia ne kete fshat kryesisht e siguron jetesen me prodhime bujqesore, blegtorale, agrumet dhe sera. Permes ketij projekti synohet te realizohen koncepte te reja dhe sa me origjinale, per te ndryshuar imazhin e ketij vendi, i cili duhet te sherbeje ne dobi te zones.

Eshte e rendesishme te kuptohet qe koncepti eshte bazuar ne kerkesat e zones, i pergjigjet nevojave te komunitetit, por njekohesisht eshte informuar nga eksperiencia te sukseshme te vendeve te tjera.

Eshte kryer nje diskutim i gjere me publikun dhe aktore te tjere per te pasur nje program sa me te gjere gjate projektimit dhe per te kuptuar se si ndikon rehabilitimi i nje hapësire urbane ne teresi.

Perfituesit

Projekti per sistemimin e shkarjes ne varrezat e fshatin Kurjan do i jape mundesi ketij komuniteti, te kene nje akses me te lehte per ti frekuentuar dhe nje vizualitet me te mire. Duke ditur mire qe tekstura e tokës është e paqëndrueshme ky projekt do te beje te mundur sistemimin nje zone te rendesishme per banoret ku perfitimet sociale do te jane te konsiderueshme.



### **Qellimi i rehabilitimit:**

Rehabilitimi i ketij objekti eshte tejet i rendesishem duke ditur mire qe tekstura e tokës është e paqëndrueshme .

Pastrimi dhe sistemimi i varrezave e bën më të lehtë lëvizjen e qytetarëve që vizitojnë të dashurit e tyre të ndjerë.

### **Parashikime ne projekt:**

Projekti parashikon qe ne sistemimin e shkarjes në varrezat e fshatit Kurjan do të realizohen punime të tilla si pastrim kanali prerje pemesh rikonstruksion muri.

Ne kete faze do te ndertohet muri me gjatësi  $L=48$  m përreth varrezave.

Do te kryhen punimet e shtresave dhe do te orientohen ujrat sipërfaqësor ne puseta

### **Kerkesat e sigurimit teknik gjate kryerjes se punimeve:**

Gjate zhvillimit te punimeve ne objekt duhet te zbatohet rregullorja e sigurimit teknik ne ndertim si me posht:

Te plotesohen kerkesat higjieno sanitare per puntoret dhe mjetet ne objekt .


Nga kontraktori duhet te sigurohen mjetet mbrojtese kolektive individuale si veshmbathje, mjete mbrojtje, etj

Te behet instruksioni teknik i sigurimit te punonjesve sipas proceseve te punes qe kryhen ne objekt

Ne objekt duhet te mbahet rregullorja e sigurimit teknik dhe protokollet per instruksionet e dhena nga personeli inxhinjero teknik.

Te punohet sipas plan organizimit te punimeve per çdo ze punimesh sipas grafikut te percaktuar ne kontrate

Te instruktohen drejtuesit e makinave meqenese punohet ne zonat te banuara, paraprakisht te bejne kontrollin e terrenit ku kalonje linjat me qellim qe te mbrohen nga renia ne tension ose



demtim i punimeve te maskuara te infrastruktures ekzistuese. Per me hollesisht kontraktori duhet te zbattoj Rregulloren e Sigurimit Teknik per punen ne ndertim , dhen nga ISTN-ja Shtator 2000.

### **Zgjidhja teknike paraqet :**

- 1- Pergatitjen e terrenit per sistemin e shkarjes , pastrimin e terrenit , germimet per zgjerimin e kanaleve , prerje dhe sistemim pemesh ,materialet e skarifikimit do te perdoren per te mbushur ku do kete nevoje, dheu do te riperdoret per mbushjen e themeleve dhe ngritjen e nivelit te tokes tek lulishtet pergjat objektit.
- 2- Punime shtresash
- 3- Punime rrugore

### **Afati i kryerjes se punimeve**

Projekti parashikon qe per kryerjen e punimeve per objektin “**Sistemimi I shkarjes së varrezave Kurjan**” nevojitet nje afat prej 1 muaj. Menyra e kryerjes se punimeve jepet ne grafikun e punimeve bashkelidhur raportit teknik.

### **Preventivi i punimeve**

Preventivi eshte hartuar ne baze te VKM 629 date 10.07.2015,i ndryshuar me çmimet e reja dhe vlere e plote eshte 2 083 250 Leke me TVSH.

**Hartoi : Ing. Samuela Plaka**

*Samuela Plaka*

